

PROCESVERBAL
nga seanca e 31-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuale
mbajtur më 27.9.2023

Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë nëpërmjet lidhjes video-konferencë: Lazo Petrushevski kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr. Alma Mashoviq, dr. Metodija Jançeski, Lllazar Trajçev, Zoran Fidanoski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /

Në seancë nëpërmjet lidhjes video-konferencë ishte i pranishëm dhe dr. Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Të pranishëm nga Shërbimi profesional nëpërmjet lidhjes video-konferencë: Maja Damevska, Cvetanka Mitrevska, Goran Radunoviq.

Të pranishmit e tjerë: /

Z. Trajçevski e hapi seancën e 31-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Seanca filloi në ora 15:30 dhe u mbajt nëpërmjet lidhjes video-konferencë.

Z. Petrushevski shpjegoi se z. Ajdini është jashtë vendit dhe se është lidhur me seancën, mund ta shikojë dhe dëgjojë por për shkaqe teknike Këshilli do të mund vetëm nëpërmjet audio lidhjes ta dëgjojë pa video paraqitje.

Z. Petrushevski në lidhje me propozimin e Rendit të ditës, sqaroi se në këtë moment, në ora 15:30, radiodifuzeri TV Kobra ka paguar mjetet e mbetura prej 50% të shumës që nuk ishte paguar për kompensimin vjetor të lejes dhe për këtë arsye ai shpjegoi se Pika 2 – Propozim për inicimin e procedurës për heqjen e lejes për transmetim televiziv të TV Kobra nga Radovishi duhet të tërhiqet (renoncohet).

Këshilli i Agjencisë njëzëri, me 6 vota „pro“ (votimi i z. Ajdini ishte nëpërmjet audio lidhjes) miratoi të korrigjuar:

RENDIN E DITËS

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga seanca e 30-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 22.9.2023.
2. Propozim-vendim për refuzimin e kërkesës me shkrim të palës së interesuar për marrjen e vendimit për shpallje të konkursit publik për dhënie të lejes për transmetim në radio të shërbimit programor në zonën e qytetit të Shkupit..
3. Të ndryshme.

Pika 1

Z. Trajçevski e anuloi miratimin e Procesverbalit të propozuar nga seanca e 30-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 22.9.2023, për arsye teknike.

Pika 2

Z. Trajçevski shpjegoi Propozim-vendimin për refuzimin e kërkesës me shkrim të pales së interesuar për miratim të Vendimit për shpallje të konkursit publik për dhënie të lejes për transmetim në radio të shërbimit programor në zonën e qytetit të Shkupit. Ai sqaroi se në muajin gusht, personi fizik ka paraqitur Kërkesë për dhënien e lejes për transmetim në radio në nivel rajonal në territorin e qytetit të Shkupit. Për këtë qëllim ASHMA-ja iu drejtua zyrtarisht AKE, e cila është kompetente për menaxhimin e spektrit të frekuencave. Gjatë ditës së djeshme është marrë njoftim se nuk ka frekuenca të lira për rajonin e Shkupit dhe sipas përgjigjes së marrë (pranuar), propozohet të merret Vendim me të cilën i refuzohet Kërkesa me shkrim.

Këshilli i Agjencisë njëzëri (votimi i z.Ajdini ishte nëpërmjet video lidhjes) miratoi Vendim me të cilën refuzon Kërkesën me shkrim nga pala e interesuar, personit fizik nga Shkupi (Nr. ynë PA1 nr.08-3212/1 datë 17.8.2023), për miratim të Vendimit për shpallje të konkursit publik për dhënie të lejes për transmetim në radio në nivel rajonal në zonën e qytetit të Shkupit, duke pasur parasysh se në pajtim me Planin për dhënien dhe shfrytëzimin e radiofrekuencave u përcaktua se nuk ka frekuenca të lira për transmetim në radio të shërbimit programor në nivel rajonal në zonën e qytetit të Shkupit, gjegjësisht nuk ka mundësi për përcaktim për ndarje të frekuencës së re.

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, vendimin e lartpërmendur ta publikon në ueb faqen e Agjencisë.

Z. Trajçevski pas votimit tha se shpreson që qytetari do të jetë këmbëngulës dhe në të ardhmen kur të krijohen kushtet, sërish do të paraqesë Kërkesë të re.

Pika 3

Të ndryshme

Nuk kishte diskutim nën Të ndryshme.

Nr. 02-3557/3

09.10.2023
Shkup

Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.